



FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË

Adresa: "Vladimir Komarov" nr. 11, 1000 Shkup; E-mail: info@piom.com.mk
Qendra Tel: (02) 3250-100; Fax: (02) 3162-275; Komisionet Invalidore Tel: (02) 3065-184

Në përputhje me Ligjin për shitjen dhe dhënien me qira të ndërtesave dhe hapësirave afariste të Republikës së Maqedonisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 13/13, 69/13, 104/13, 27/14, 42/14, 178/14, 180/14, 51/15 dhe 61/15), Vendimin e Këshillit drejtues të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë nr. 02-2313/1 prej 24.04.2015 për dhënien e hapësirës afariste me qira për një periudhë më të gjatë se dy vjet dhe Rregulloren mbi mënyrën dhe kushtet për shitjen dhe dhënien e hapësirës afariste me qira në pronësi apo shfrytëzim të përhershëm të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 197/14)

Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë PUBLIKON

SH P A L L J E nr. 02/2015

PËR DHËNIEN E HAPËSIRËS AFARISTE ME QIRA PËRMES ANKANDIT ELEKTRONIK PUBLIK

LËNDË E ANKANDIT ELEKTRONIK PUBLIK

Lëndë e ankandit elektronik publik është **DHËDHIA E HAPËSIRËS AFARISTE ME QIRA** në pronësi apo e dhënë në përdorim të përhershëm Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë në përputhje me Pasqyrën tabelore e cila përmban të dhënat për hapësirën afariste, nr. e parcelës kadastrale, sipërfaqen e hapësirës afariste, adresën, çmimin total fillestar, garancinë bankare, afatin e dorëzimit dhe kohën e ankandit publik.

Hapësira afariste nën numr rendor 1 dhe 2 nga pasqyra tabelore jepet me qira për një periudhë prej 7 vjet me mundësi të vazhimit të kontratës, ndërsa hapësirat afariste nga nr.3 deri në nr. 12 nga pasqyra tabelore jepen me qira për një periudhë prej 2 vjet me mundësi të vazhimit të kontratës.

Nr. R.	Numri i Parcelës kadastrale, Komuna kadastrale dhe Fletëpronësia	Qyteti, Komuna, adresa	Përshkrim i hapësirës afariste	Sipërfaqja M2	Çmimi fillestar i qirasë mujore (vlera e parashikuar e tregut) pa TVSH	Vlera totale e parashikuar e hapësirës afariste në denarë	Garanci bankare për seriozitetin e ofertës në denarë, 25% nga vlera totale e parashikuar	Afati për dorëzimin e fletëparaqitjes për pjesëmarrje në ankand publik	Koha e fillimit të ankandit publik
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	PK 4530, KK Çair, FP 958705	Shkup - Çair Rr. Xhon Kenedi nr. 18	Shtëpia e pensionistëve – Çair përdhese 437M2 bodrum 137M2	584	35.259	7.051.836	1.762.959	12.05.2015	15.05.2015 ora 10,00

2	PK 14299, KK Kumanovë, FP 3793	Kumanovë-Kumanovë rr.Done Bozhinov nr. 45	Shtëpia e pensionistëve – Kumanovë përdhese 412 m2	412	19.762	3.952.359	988.090	12.05.2015	15.05.2015 ora 10,30
3	PK 5130, KK Gostivar – 2 , FP 34272	Gostivar – Gostivar, rr.Çede Filipovski nr. 17 b	Shtëpia e pensionistëve – Gostivar përdhese 41m2	41	10.928	2.185.648	546.412	12.05.2015	15.05.2015 ora 11,00
4	PK 5130, KK Gostivar-2, FP34272	Gostivar – Gostivar, rr.Çede Filipovski nr. 17 b	Shtëpia e pensionistëve – Gostivar përdhese 25m2	25	7.047	1.409.395	352.349	12.05.2015	15.05.2015 ora 11,30
5	PK 5130, KK Gostivar-2, FP34272	Gostivar – Gostivar, rr.Çede Filipovski nr. 17 b	Shtëpia e pensionistëve – Gostivar përdhese 38m2 bodrum 38m2	76	12.869	2.573.713	643.428	12.05.2015	15.05.2015 ora 12,00
6	PK 778, KK Kisela vodë-2, FP 2829	Shkup –Aerodrom, rr.Angel Dimovski nr. 4	Shtëpia e pensionistëve – Aerodrom përdhese 43m2	43	8.403	1.680.610	420.153	12.05.2015	15.05.2015 ora 12,30
7	PK 1042, KK Gazi Babë, FP 9232	Shkupe-Gazi Babë, rr.Jani Lukrovski nr. 3	Shtëpia e pensionistëve – Autokomandë përdhese15m2	15	2.602	520.413	130.103	12.05.2015	15.05.2015 ora 13,00
8	PK 8611, KK Draçevë - 1, FP 69038	Shkup -Kisela Vodë, rr. Ratko Mitroviq nr. 8 Draçevë	Klubi i pensionistëve – Draçevë përdhese 437m2	437	27.596	5.519.133	1.379.783	12.05.2015	15.05.2015 ora 13,30
9	PK 12207, KK Koçan, FP 12384	Koçan- Koçan, rr. Dimitar Vlahov nr. 5	Filiali i FSPIM Koçan përdhese 15,5m2	16	1.872	374.412	93.603	12.05.2015	15.05.2015 ora 14,00
10	PK 12207, KK Koçan, FP 12384	Koçan- Koçan, rr. Dimitar Vlahov nr. 5	Filiali i FSPIM Koçan përdhese 12m2	12	1.464	292.863	73.216	12.05.2015	15.05.2015 ora 14,30
11	PK 366, KK Kriva Pallankë, FP 8335	Kriva Pallankë-Kriva Pallankë, rr. Marshall Tito p.n.	Shtëpia e pensionistëve – Kriva Pallankë përdhese 171m2	171	7.972	1.594.449	398.612	12.05.2015	15.05.2015 ora 15,00
12	PK 7509, KK Dellçevë, FP 1608	Dellçevë-Dellçevë, rr. Kej na osloboduvanje nr. 4	Shtëpia e pensionistëve – Delçevë bodrum 120m2	120	8.173	1.634.547	408.637	12.05.2015	15.05.2015 ora 15,30

E DREJTA E PJESËMARRJES

Të drejtë për pjesëmarrje në ankand publik kanë:

1. **Personat fizik:** shtetas të Republikës së Maqedonisë, shtetas të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD) si dhe shtetas të vendeve që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD, ndërsa nën kushte të reciprocitetit mund të fitojnë të drejtën e pronësisë së hapësirës afariste në territorin e Republikës së Maqedonisë.

2. **Personat juridik:** personi juridik vendas, personi juridik në pronësi të përbashkët, personi juridike i themeluar nga personi i huaj fizik dhe juridik, të regjistruar në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë, personat juridik të huaj, rezidentë në vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD si dhe personat juridik të huaj, rezidentë në vendet që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe të OECD, ndërsa të cilët nën kushte të reciprocitetit mund të fitojnë të drejtën e pronësisë së hapësirës afariste në territorin e Republikës së Maqedonisë.

KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKAND ELEKTRONIK PUBLIK

Personat e interesuar fizik dhe juridik dorëzojnë fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankand publik, në mënyrë elektronike dhe në letër, veçmas për çdo hapësirë afaristetë të kompletuar me dëshmitë e mëposhtme:

1. Personat e interesuar fizik dhe juridik paraqiten në sistemin për shitjen dhe dhënien e hapësirës afariste me qira në pronësi të RM-së, përkatësisht në web portalin www.deloven-prostor.mk dokumentet në formë letre dorëzohen në Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë, në një zarf të mbyllur me një shënim „Mos e Hap deri në përfundimin e shpalljes“,
2. Garanci bankare për seriozitetin e ofertës për pjesëmarrje në ankand publik në shumë prej (25% e vlerës së çmuar) me afat të vlefshmërisë prej 60 ditësh nga dita e ankandit publik vetëm në origjinal (të shënohet numri rendor i pasqyrës tabelore dhe adresa ku gjendet objekti afarist),
3. Për personat fizik, vërtetësi mbi shtetësinë, origjinal ose kopje e noterizuar, jo më të vjetër se 6 muaj,
4. Për personat juridik gjendjen aktuale nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë (për ofruesin e huaj dëshmi përkatëse mbi regjistrimin e personit juridik e lëshuar nga regjistri përkatës), në origjinal ose kopje e noterizuar, jo më të vjetër se 6 muaj,
5. Pjesëmarrësit e interesuar regjistrohen në portalin www.deloven-prostor.mk duke shënuar e-mail adresën e dorëzuesit të fletëparaqitjes përmes së cilës do të realizohet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në ankan elektronik publik, me çka duhet të aktivizojë llogarinë shfrytëzuese (shih udhëzimin për shfrytëzuesit në www.deloven-prostor.mk)
6. Vërtetim se nuk është hapur procedurë për falimentim apo likuidim,
7. Certifikatë se, me aktgjykim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar një masë e sigurimit: ndalim për kryerjen e veprimtarisë,
8. Gjatë bashkangjities së dokumenteve, ofruesit e interesuar, në fushën „Deklaratë“ nevojitet që në një dokument të vendosin të gjitha dokumentet e nevojshme nga shpallja, përveç Garancisë bankare, ndërsa në fushën „Garanci bankare“ vendoset garancia bankare e skanuar.

Fletëparaqitjet që nuk janë kompletuar me këto dëshmi nuk do të marrin pjesë në ankand elektronik publik, me çka parashtruesit e fletëparaqitjeve jo të kompletuara do të njoftohen në mënyrë elektronike.

AFATET

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në ankand publik mund të parashtrohen brenda 15 ditëve nga dita e shpalljes, përkatësisht duke filluar prej 28.04.2015, përfundimisht deri më 12.05.2015 në mënyrë elektronike në faqen e internetit: www.deloven-prostor.mk
Ankandi publik do të mbahet në mënyrë elektronike në këtë faqe të internetit: www.deloven-prostor.mk
Ankandi publik do të fillojë në afatin e shënuar në pasqyrën tabelore, veçmas për çdo hapësirë afariste.

PROCEDURA

1. Pas pranimit të fletëparaqitjes, Komisioni përcakton plotësinë e dokumentacionit në përputhje me kushtet në shpallje, sipas së cilës informon parashtruesit e fletëparaqitjes në mënyrë elektronike.
2. Parashtruesve të fletëparaqitjeve të cilët janë të kompletuara, komisioni në mënyrë elektronike ua miraton pjesëmarrjen në ankand publik me çka edhe njoftohen në mënyrë elektronike përmes e-mail-it, ndërsa parashtruesve të fletëparaqitjeve të cilët nuk kanë dorëzuar dokumentacion të kompletuar, komisioni nuk ua miraton pjesëmarrjen në ankand publik, me çka edhe i njofton në mënyrë elektronike për arsyet e rrefuzimit.
3. Ankandi publik do të mbahet nëse pjesëmarrësit i plotësojnë kushtet e përcaktuara në shpallje.
4. Ankandi publik do të mbahet edhe nëse pas shpalljes është paraqitur vetëm një pjesëmarrës i cili plotëson kushtet e përcaktuara në shpallje.
5. Ankandi publik fillon me shpalljen e çmimit total fillestar të hapësirës afariste dhe zbatohet me ankand nga ana e pjesëmarrësve. Në pesë minutat e para të ankandit publik pjesëmarrësit mund ta pranojnë, përkatësisht të rrisin çmimin e hapësirës afariste. Ankandi publik konsiderohet i përfunduar në momentin e kalimit të kohës dhe po qe se në dy minutat e fundit të kohës së caktuar për kohëzgjatjen e ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve është dhënë oferta, afati përfundimtar për përfundimin e ankandit publik do të zgjatet edhe për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur në periudhën e dy minutave të ardhshme nuk do të jepet ofertë e re.
6. Ankandi publik vazhdon një kohë të pacaktuar deri kur në një interval prej dy minutash ka ofertë të re. Nëse në pesë minutat e para të ankandit publik nuk është pranuar oferta, përkatësisht nuk është dhënë një më e lartë, çmimi total fillestar i hapësirës afariste reduktohet për 2% sipas së cilit pjesëmarrësit e ankandit publik sërish do të kenë mundësinë të pranojnë, përkatësisht rrisin çmimin e hapësirës afariste.
7. Nëse në dy minutat e fundit nga pesë minutat e dyta të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve është pranuar oferta, përkatësisht është dhënë ofertë më e lartë, afati për përfundimin e ankandit publik do të zgjatet edhe për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur në dy minutat e ardhshme nuk është dhënë ofertë e re.
8. Nëse në kohëzgjatjen e pesë minutave përsëri nuk ka asnjë ofertë, vlera e hapësirës afariste sërish reduktohet për 2% nga çmimi total fillestar i hapësirës afariste. Reduktimi i çmimit total fillestar i hapësirës afariste gjatë ankandit mund të arrijë më së shumti në 30% nga vlera e caktuar e tregut të hapësirës afariste, pa marrë parasysh se sa ofrues janë paraqitur në ankand publik.
9. Komisioni pas përfundimit të ankandit publik përgatit procesverbal për ankandin publik të zbatuar i cili u dorëzohet të gjithë pjesëmarrësve në ankandin publik.
10. Pjesëmarrësit në ankand publik kanë të drejtë të kundërshtojnë vetëm në lidhje me procedurën e ankandit publik, në afat prej tre ditësh nga mbajtja e ankandit publik, deri te Komisioni i cili vendos me Aktvendim sipas kundërshtimit, brenda 5 ditëve nga pranimi i kundërshtimit.
11. Si ofrues më i mirë konsiderohet pjesëmarrësi i ankandit publik i cili ka ofruar çmim total përfundimtar më të lartë, i cili përfaqëson çmimin më të lartë për dhënien me qira të hapësirës afariste.
12. Ofruesi më i volitshëm është i detyruar që brenda 15 ditëve nga pranimi i njoftimit me shkrim për zgjedhjen të paguajë mjetet si depozitë apo të sigurojë garanci bankare për sigurimin e obligimeve në lartësi prej 2 (dy) qirave mujore në përputhje me çmimin e arritur përfundimtar të ankandit dhe Komisionit t'ia dorëzojë dëshminë, në të kundërtën nuk do të nënshkruajë marrëveshjen, ndërsa garancia bankare do të aktivizohet dhe ofruesit do t'i shqiptohet ndalesë për pjesëmarrje në procedurën për ankand publik për tjetërsimin apo dhënien me qira të hapësirës afariste për një periudhë prej një viti nga dita e shqiptimit të ndalesës.
13. Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë në afat prej 5 ditësh pas pagesës së kryer të depozitës do të lidhë marrëveshje për qira të hapësirës afariste me ofruesin më të volitshëm.
14. Tatimi i vlerës së dhënë mbulohet nga ofruesi më i volitshëm.
15. Marrëveshja për qiranë e hapësirës afariste solemnizohet në Noter në shpenzim të ofruesit më të volitshëm.

16. Garancia bankare për seriozitetin e ofertës për pjesëmarrje në ankand publik do t'i kthehet parashtruesit të fletëparaqitjes në afat prej 15 ditësh nga dita e mbajtjes së ankandit publik, ndërsa garancia bankare ofruesit më të volitshëm do t'i kthehet në afat prej 15 ditësh nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes për qira .

Kjo shpallje do të publikohet edhe në WEB faqen e Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë, www.piom.com.mk dhe në faqen e internetit: www.deloven-prostor.mk

Të interesuarit, hapësirën afariste mund ta shohin çdo ditë pune prej orës 10,00 deri në orën 14,00.

Informata më të hollësishme mund të merren në selinë e Fondit të SPIM-së – Shkup, rr. Vladimir Komarov nr. 11.

Personat për kontakt:

Ajredin Amzai tel.. 070/360-243

Luben Veljanoski tel. 071/392-576

**Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë
Komisioni për zbatimin e procedurës për ankand publik**